

Tiranë më 25.06.2024

KËRKESË

Kërkues:

Drejtuar: Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Objekti: Konstatimin e përfundimit të parakohshëm të mandatit për Kryetarin e Bashkisë Himarë Z.Fredi Beleri

Baza Ligjore: Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, Neni 10, pika të ligjit nr. 138/2015 “Për Garantimin e Integritetit të Personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (ndryshuar me ligjin nr 38/2016, 14.4.2016)

Të nderuar !

Duke marrë shkas nga njoftimi publik se Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar vendosi: Lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe deklarimin fajtor të shtetasit Fredi Beleri për veprën penale , parashikuar nga neni 328 i K. Penal “ Korrupsioni pasiv ne zgjedhje”, dhe dënimin e tij me 2 vite burgim, parashtrajmë kërkesën tone si më poshtë vijon:

Në zbatim të dispozitave të parashikuara nga Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 2, pika1/b dh 4 të ligjit nr. 138/2015 “Për Garantimin e Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” , të cilat parashikojnë se nuk mund të ushtrojë funksionin publik të Kryetarit të Bashkisë, personi i dënuar me vendim të formës së prerë. Gjithashtu sqarojmë se, në referim te dispozitave të parashikuara nga neni 10 i ligjit 138/2015 në rastet kur verifikohen kushtet për moskandidim apo moszgjedhje, organi kompetent KQZ-ja kryen veprimet e mëposhtme:

ç) shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen, si dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor,

Sa më sipër, duke marrë parasysh mbarimin para kohe të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë Z.Fredi Beleri, për shkak të dënimit të tij me vendim penal të formës së prerë , deklarimin fajtor si dhe dënimin e tij me 2 vite burgim, kërkojmë nga ana juaj, në përputhje me pikën 4 të nenit 61 të ligjit 139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, të konstatohet përfundimi i

parakohshëm i mandatit dhe të organizohen zgjedhje të pjesshme për Kryetarin e Bashkisë Himarë në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Duke shpresuar në bashkëpunimin tuaj!

KËRKUES

Eugen Basha

[shqiptarja.com]